

BUJQËSIA NË FOKUS

Roli, impakti dhe keqpërdorimet e fondeve mbështetëse



Autori: INDEP

Programi: Qeverisje Demokratike

Publikuar: Tetor, 2023

Projekti “Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Rritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.

PËRMBAJTJA

HYRJE 4

METODOLOGJIA 5

BAZA LIGJORE 6

GJENDJA AKTUALE E
SEKTORIT TË BUJOËSISË
NË KOSOVË 8

KEQPËRDORIMET E
SUBVENCIONEVE DHE
GRANTEVE 12

PËRFUNDIME 15

REKOMANDIME 16

HYRJE

Bujqësia është, dhe konsiderohet të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm dhe më me rol strategjik për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Megjithatë, ky sektor, vazhdon të karakterizohet me ferma relativisht të vogla me sipërfaqe mesatare prej 5ha [1], jostabilitet, produktivitet të ulët, si dhe shërbim këshilldhënës dhe proces monitorimi të dobët [2]. Në anën tjetër, sfida e ushqimit mbetet një ndër sfidat më të mëdha me të cilat shoqëria jonë vazhdon të përballet pavarësisht incentivave, investimeve në këtë sektor. Fakti që 26% e popullsisë është e papunë dhe që 23% jeton në ose nën kufirin e varfërisë [3] me pamundësi të përmbushjës së nevojave ushqimore pa u ndihmuar nga shteti nëpërmjet skemave sociale, vazhdon të jetë mjaft shqetësues. Ndër të tjerash, vendi po përballet edhe rritje enorme të çmimeve të të mirave esenciale për jetesë. Rritja e inflacionit në treg përfshirë atë të Kosovës me 12.7% [4], ka ndikuar që çmimi i bukës ndër vite të rritet për 100% dhe ai i vajit për 130%. Rrjedh pyetja:

SA FRYTDHËNËSE JANË VËRTETË INVESTIMET MILIONËSHE?

Ndarja e granteve dhe subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, vazhdon të mbetet një ndër temat më delikate që nga prezantimi i tyre në vitin 2009. Pavarësisht investimeve milionëshe, nuk është hetuar ndonjë rritje e kënaqshme e të ardhurave bruto kombëtare apo rritje e eksportit të produkteve bujqësore. Për më tepër, rritja e importit si dhe inflacioni në treg vetëm sa po dobësojnë buxhetin e konsumatorëve dhe vetë ndërmarrësve. Fondet e taksapaguesve si dhe ndihmat e dhuruara nga organizatat e shumëta në vend që të nxisin zhvillimin e tregut bujqësor, vetëm sa po e sfidojnë atë. Mungesa e monitorimit në njërën anë, si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet organeve të përfshira në anën tjetër, lënë mjaft zbrazëtirë për keqpërdorim të mjeteve, fondeve publike të Republikës së Kosovës.

Ky raport tematik ofron një analizë të situatës aktuale të sektorit bujqësor, përfshirë vlerësimin e produktivitetit, adresimin e sfidave, si dhe vlerësimin e impaktit të skemave mbështetëse, të granteve dhe subvencioneve të shpërndara gjatë viteve të fundit. Për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve kompetente, janë hulumtuar të gjithë indikatorët duke filluar nga ndarja e buxhetit e Republikës së Kosovës për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), alokimin e fondeve për subvencione dhe grante, legjislacionin që mbulon skemat mbështetëse, ndikimin e tyre në tregun bujqësor dhe shqyrtimin e rasteve të mundshme të keqpërdorimeve gjatë zbatimit të tyre.



[1] Projekt Koncept Dokumenti për Organizimin e Tregut të Përbashkët të Produkteve Bujqësore, Zyra e Kryeministrit, e qasshme në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41305>

[2] Bujqësia në Kosovë, wikipedia, e qasshme në: https://sq.wikipedia.org/wiki/Bujq%C3%ABsia_n%C3%AB_Kosov%C3%AB

[3] Annual Report 2021, UNICEF Kosovo Programme, e qasshme në: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/reports/annual-report-2021>

[4] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, e qasshme në:

<https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-shtator-2022>

METODOLOGJIA

Analiza tematike ofron një studim të plotë të zhvilluar përmes një metodologjie hulumtuese që kombinon aspektet cilësore dhe ato sasiore. Procesi i hulumtimit përfshin një shqyrtim të gjerë të dokumenteve relevante, si dhe përpunimin e të dhënave dhe informacionit nga një sërë burimesh të ndryshme përfshirë raportet e publikuara nga institucionet e monitoruara dhe grupeve të ndryshme. Përdorimi i një hulumtimi të tillë që integron elemente cilësore dhe sasiore, ka mundësuar një eksplorim më të hollësishëm të temës së përzgjedhur, duke theksuar më tej vlefshmërinë dhe besueshmërinë e zbulimeve të prezantuara në këtë raport.

Për ta bërë këtë raport sa më gjithëpërfshirës dhe relevant, janë organizuar takime si dhe forume avokuese me përfaqësues nga MBPZHR si dhe zyrtarë nga AZHB. Përveç kësaj, janë intervistuar akterë institucional të nivelit qendror, të nivelit komunal, përfaqësues të bizneseve të ndryshme, investitorë potencial si dhe bujq dhe fermerë, përfitues nga skema mbështetëse. Këto intervistime na mundësuan të mbledhim njohuri, të mësojmë detaje që legjislacioni shpesh herë nuk i parasheh, si dhe të fitojmë ekspertizë në këtë fushë. Për më tepër, për t'u pajisur me infomata të dorës së parë, monitoruesit tanë në mënyrë aktive morën pjesë në procesin e shpërndarjes së subvencioneve duke rritur kështu saktësinë dhe besueshmërinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit. Gjithashtu, përpunimi dhe prezantimi grafik dhe tabelar i të dhënave të grumbulluara, do të ndihmojë në identifikimin e sfidave, duke ofruar një pasqyrë të qartë të gjendjes të sektorit të bujqësisë ndër vite.



BAZA LIGJORE

Në Kosovë, skemat mbështetëse për herë të parë u prezantuan 14 vite më parë me miratimin e Ligjit Nr.03/L-098, Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Para miratimit të këtij ligji, në sektorin e bujqësisë ekzistonin gjithsej 15 ligje dhe 13 rregullore, të cilat deri në vitin 2008 ishin në përputhje me kornizën legjislative të UNMIK-ut. Sot, sektori i bujqësisë udhëhiqet nga gjithsej 28 ligje dhe 15 rregullore të publikuara në faqën zyrtare të MBPZHR-së. Ligjet rregulluese për programet e mbështetjes në sektorin agro-rural janë orientuar drejt promovimit të zhvillimit të këtij sektori, duke e bërë atë më konkurrues dhe inovativ, me qëllim të ofrimit të të mirave cilësisë së lartë në tregun vendor dhe atë të Bashkimit Evropian. Këto ligje synojnë gjithashtu një përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të mjedisit, duke krijuar mundësi të reja punësimi dhe përfshirje sociale. Përveç kësaj, ato janë të përqendruara në thurjen e rregullave dhe udhëzimeve për zbatimin e efektshëm të skemave në bujqësi, ndërsa janë të vendosura me qëllim për të parandaluar keqpërdorimin e parasë publike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë edhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është organi përgjegjës për përpilimin e modeleve, në bazë të së cilave gjejnë zbatim programet me kohëzgjatje afatshkurte, afatmesme dhe afatgjate, për përfitim të projekteve nga agrobizneset dhe fermerët. Institucioni tjetër që merret me hartimin e skemave mbështetëse që nga viti 2013, është Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Këto organe, hartojnë kriteret dhe kushtet për përfituesit e projekteve të cilat në fund aprovohen nga Ministri. Fondet e miratuara nga Qeveria e Kosovës që kanë për qëllim vetë fuqizimin e fermerëve dhe zgjerimin e agrobizneseve shpërndahen në dy forma: Përmes granteve apo projekteve zhvillimore të destinuara për investime afatgjata përfshirë kushtet që stimulojnë zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit, si dhe nëpërmjet subvencioneve apo pagesave direkte për fermerët apo bujqit që merren me prodhimtarinë primare bujqësore.

Në Strategjinë Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SKBZHR) përcaktohen objektivat afatgjate strategjike. Ky dokument miratohet nga Qeveria me propozim të Ministrisë për një periudhë shtatë vjeçare. Në bazë të saj, hartohet Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në të cilin përcaktohen objektivat afatmesme strategjike. Ky dokument duhet të përfshijë periudhën prej më së paku 3 deri në 7 vjet [5]. PKBZHR-ja përbëhet prej dy shtyllave: Programit për Zhvillim Rural dhe Programit për Pagesa Direkte, në të cilat janë të përcaktuara objektivat afatshkurtëra me kohëzgjatje prej 1 viti. Programet duhet të miratohen deri më 20 dhjetor të vitit aktual apo më së largu deri më 20 janar të vitit të ardhshëm [6]. Në kuadër të këtyre programeve, shpallen shtyllat të cilat do të mbështeten brenda periudhës përkatëse. Masat e huazuara nga programi evropian IPARD, në Kosovë nuk financohen direkt nga fondi i BE-së [7], megjithatë, Bashkimi Evropian ofron asistencë në përmirësimin e standardeve bujqësore, me qëllim të rritjes të kapaciteteve teknologjike, duke promovuar një treg të lirë bujqësor në bashkëpunim me shtetet anëtare të BE-së.

[5] Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Projekt Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, e qasshme në: https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/PROJEKT_LIGJI_PER_BUJQESI_DHE_ZHVILLIM_RURAL_2018.pdf

[6] Ibid.

[7] Raporti i auditimit të performancës, procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë, Zyra Kombëtare e Auditimit, e qasshme në: http://www.zka-rks.org/wpcontent/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf

Programi i Zhvillimit Rural në Kosovë është një ndër përpjekjet më të rëndësishme për të fuqizuar sektorin bujqësor dhe për të përmirësuar kushtet e fshatrave. Masat mbështetëse që përfshijnë financim, diversifikim, përmirësimin e infrastrukturës, mbështetje për tregtinë e produkteve bujqësore dhe kujdesin për mjedisin, synojnë të ndihmojnë rritjen e produktivitetit bujqësor, diversifikimin e ekonomisë rurale, dhe kujdesin për mjedisin, duke krijuar kështu mundësi të reja për zhvillim ekonomik dhe rritje të mirëqenies sociale.

Prej masave të listuara, masat nr. 1,5,7 dhe 9 janë ato të cilat gjejnë zbatim në tregun tonë:

Masa # 1

“Investime në asetet fizike të njësive bujqësore” ndihmon fermat të investojnë në ndërtesa ose teknologji;

Masa # 3

“Investime në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit” synon gjithashtu të siguroj që projektet në kompanitë e përpunimit të ushqimit, përmbushin standardet e sigurisë dhe mjedisit të BE-së;

Masa # 4

“Agro-mjedis-klimë dhe bujqësi organike” (Nuk implementohet në Republikën e Kosovës në kuadër të Programit nga MBPZHR);

Masa # 5

“Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER” financon grupet lokale të veprimit që zbatojnë strategjitë e tyre të zhvillimit lokal nga poshtë lart;

Masa # 7

“Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit” është për bizneset rurale dhe familjet fermere që kërkojnë të zhvillojnë aktivitete jobujqësore;

Masa # 9

“Asistenca teknike” mbështet trajnimet, analizat, monitorimin e programit, ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e grupeve lokale të veprimit.



GJENDJA AKTUALE E SEKTORIT TË **BUJQËSISË NË** **KOSOVË**

Edhe pse 54.23% e tokës në Kosovë është e kualifikuar si tokë bujqësore [8], bujqësia është një sektor që, pavarësisht iniciativave të saja me qëllim të stabilizimit të gjendjes ekonomike, fatkeqësisht, vazhdon të përballet me modele që jo gjithmonë po rezultojnë të jenë frytdhënëse. Sipas disa bujqëve dhe fermerëve, shqetësimet e tyre nuk lidhen vetëm me shndërrimin e tokës në zona industriale, por mbi të gjitha, me mënyrën e subvencionimit të kulturave të tyre si dhe shpërndarjen e fondeve mbështetëse pas sezonit të korrave, duke u ballafaquar gjithashtu me padrejtësitë përgjatë shpërndarjes së tyre.


**SYNIMI I MINISTRISË SË
BUJQËSISË, PYLLTARISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR
TË ZHVILLUAR SEKTORIN E
BUJQËSISË MBETET ENDE
SFIDË SI PASOJË E MOS
ZBATIMIT TË STRATEGJISË
KOMBËTARE NË PËRPTHJE
ME OBJEKTIVAT E
PARASHTRUARA.**

[8] Burimet natyrore të Kosovës. | Wikipedia. Je qasimë në https://sq.wikipedia.org/wiki/Burimet_natyrore_t%C3%AB_Kosov%C3%ABs


Fondi i ndarë nga Qeveria e Kosovës për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës 2018 - 2023 arrin shifrën prej

382,038,720 milionë euro nga
15,205,192,010 miliardë euro [9]
 apo
2.51%.

Kjo përqindje, dukshëm është më e vogël në krahasim me % që ndahet për zhvillimin e politikave të përbashkëta bujqësore mbrenda BE-së me pjesëmarrje mesatare prej 40% [10].



Grafiku 1. Raporti ndërmjet buxhetit të ndarë për MBPZHR-në krahas buxhetit të përgjithshëm të Kosovës [12]



Grafiku 2. Vlerat krahasuese ndërmjet planifikimit dhe implementimit të skemave mbështetëse në Kosovë gjatë viteve 2018 -2023 [13]

Grafiku i mësipërm pasqyron marrëdhënien ndërmjet zbatimit si dhe planifikimit të granteve dhe të subvencioneve përgjatë 6 viteve të fundit. Relacioni ndërmjet këtyre dy indikatorëve është pothuajse në harmonizim deri në vitin 2020. Fatkeqësisht, tashmë lidhur mbi implementimin e shumave të shpërndara gjatë dy viteve të fundit ende nuk janë të njohura për publikun.

GRANTET QEVERTARE

janë ndihmat e qeverisë në formë të transferit të burimeve apo mjeteve në një ndërmarrje si përgjigje për pajtimin e saj në të kaluarën apo në të ardhmen me kushtet e caktuara që ndërlidhen me aktivitetet afariste të ndërmarrjes [14]. Në rastin tonë me "aktivitete afariste" duhet nënkuptuar të gjitha veprimtaritë që përfshijnë ofrimin, sigurimin ose prodhimin e produkteve bujqësore në treg të hapur.

SUBVENCIONET

nënkuptojnë transferet që u paguhen agrobizneseve, organizatave bujqësore apo individëve të cilët arrijnë të plotësojnë kriteret e shpallura në thirrjen përkatëse.

Fakti që Grantet Qeveritare janë rritur për 31.19% dhe Subvencionet dhe Transferet për 21.65% mbrenda të njëjtës periudhë kohore, lë për të shpresuar për një sektor bujqësor më të qëndrueshëm në një të ardhme të afërt.

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Vlera e planifikuar	52,000,000	50,500,000	67,100,000	53,000,000	73,500,000	100,000,000
Vlera e Implementuar	60,600,000	46,700,000	79,000,000			

Tabela 1. Vlerat krahasuese ndërmjet planifikimit dhe zbatimit të skemave mbështetëse përgjatë viteve 2018 -2023

Në vitin 2018, buxheti total i destinuar për grante dhe subvencione ishte 52 milionë, ndonëse 60.6 milionë ishte vlera totale e investuar. Në vitin 2019, vlera e ndarë ishte 50.5 milionë, ndërkaq vetëm 46.7 milionë kanë gjetur zbatim. Në vitin 2020, vlera e investuar ishte 79 milionë kundrejt faktit që vetëm 67.1 milionë ishin ndarë në fillim. Në vitin 2021, u miratua vlera prej 53 milionë euro. Në vitin 2022, vlera prej 73.5 milionë dhe për vitin 2023, gjithsejtë 100 milionë euro u premtuan. Fatkeqësisht, thirrja për grante për vitin 2023 nuk është hapur ende, ndërkaq, të dhënat për zbatimin e fondeve mbështetëse për vitin 2021 dhe 2022 mbeten të zbulohen në të ardhmen.

[9] Vlerat janë llogaritur në bazë të të dhënave nga Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës ndër vite

[10] Agriculture and rural development, European Commission, e qasshme në:


https://agriculture.ec.europa.eu/common-agricultural-policy/financing-cap/cap-funds_en#overview

[12] Vlerat janë llogaritur në bazë të të dhënave nga Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës ndër vite;

[13] Ibid;

[14] SKK 7, Kontabiliteti për grantet qeveritare dhe shpallja e ndihmës qeveritare, Ministria e Financave, e qasshme në:

<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3083D7E-36A9-4816-87BD-38C634651F9E.pdf>.



Grafiku 3. Sipërfaqet bujqësore (Ha) sipas kategorive të shfrytëzimit në 2020-2021 [15]

Në Kosovë **54.23%** e tokës është e kualifikuar të jetë **TOKË BUJQËSORE** ose 342.400 hektarë të zonës së saj. Megjithatë, sektori formal bujqësor mbulon vetëm **3.9% TË FUQISË PUNËTORE TË PËRGJITHSHME.**



SIPAS ASK-SË, INFLACIONI NË MUAJT E KALUAR KA ARRITUR VLERËN PREJ 4.2%. [16]

Treguesi që 61.7% e popullsisë jeton në zona rurale [17] që nga viti 2011 padyshim që nuk qëndron më. Migrimi i rinisë drejt qyteteve po vazhdon të thellohet duke lënë pas hektarë (Ha) tokë pjellore të pa shfrytëzuar. Mungesa e fuqisë punëtore në njërin anë dhe betonimi i tokës pjellore në anën tjetër, nuk lë hapësirë të mjaftueshme për investime. Sipas regjistrimit të fundit të bujqësisë, thuhet se sipërfaqja e përgjithshme tokës që shfrytëzohet në Kosovë është 512 mijë hektarë tokë, me mesatare prej 3.9 hektarë tokë për ekonomi bujqësore [18]. Rendimenti i humbjes së tokës bujqësore me 1000 ha/vit nga erozioni dhe afërsisht 500-100 ha për qëllime ndërtimore [19] është për 4 fish më i lartë se ai i përpunimit të tokës bujqësore i cili gjatë pesë viteve të fundit është rritur për 582 ha/vit [20].



Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Drithërat	82.9	105,7	99.9	109,1	163,3
Bimë foragjere	111,7	108,6	107,3	109,2	146,7
Perime	108,1	104,8	108,3	120,9	139,4
Pemë	103,8	113,0	132,1	142,2	139,8
Blegtoria	99.9	105,4	101,1	111,1	139,6
Prodhimet blegtorale	103,4	105,8	110,9	107,4	129,7

Tabela 2. Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore 2018-2022 (2015=100)18 [21]

[15] Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, i qasshëm në:

<https://askapi.rks-gov.net/Custom/d3897cdf-04b9-4167-a0f3-2bd7ef842703.pdf>

[16] Agjencia e Statistikave të Kosovës, e qasshme në:

<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/>

[17] Radio Evropa e Lirë, e qasshme në:

<https://www.evropaelire.org/a/qytetet-fshatrat-kosova/30081494.html>

[18] Ibid


[19] Tokat e Kosovës, Wikipedia, e qasshme në: https://sq.wikipedia.org/wiki/Tokat_e_Kosov%C3%ABs

[20] Raporti i Gjellbër 2021, MBPZHR, i qasshme në:


https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_202003022021.pdf

[21] Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023, fq.164, e qasshme në:

<https://askapi.rks-gov.net/Custom/d3897cdf-04b9-4167-a0f3-2bd7ef842703.pdf>



Grafiku 4. Raporti ndërmjet importit dhe eksportit të prodhimitarisë bujqësore 2019 - 2022 [22]



Grafiku 5. Indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore në ton 2018-2022 (2015=100)[23]

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Lloji i kafshëve	Numri i kafshëve gjithsejtë					
Gjedhe	259,729	258,662	25,7733	261,389	260,528	250,899
Derra	41,086	40,164	40,538	45,394	4,7384	45,420
Dele	182,278	181,105	189,102	212,131	211,354	204,110
Dhi	28,410	28,703	27,197	29,557	30,039	29,378
Njëthundrak	2,326	1,944	2,037	1,804	1,864	1,469
Koshere bletësh	163,717	182,476	219,831	262,541	219,077	219,077
Shpezë	2,811,385	2,568,032	2,665,262	2,781,913	2,788,435	2,614,438

Tabela 3. Blegtoaria sipas llojeve 2017 - 2022 [24]

[22] Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023, i qasshëm në: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/d3897cdf-04b9-4167-a0f3-2bd7ef842703.pdf>

[23] Ibid;

[24] Ibid;



KEQPËRDORIMET

E SUBVENCIONEVE
DHE GRANTEVE

“DISA PREJ ATYRE QË JANË NDIHMUAR NGA PERSONA TË
CAKTUAR, KANË ABUZUAR ME PARANË PUBLIKE DUKE I MBYLLUR
FERMAT, DUKE E MASHTRUAR MINISTRINË OSE DUKE MOS I
IMPLEMENTUAR ATO DERI NË FUND.

KA FERMERË QË NUK KANË KU T’I MBAJNË LOPËT DHE
DETYROHEN T’I SHESIN ATO.”

Përkundër faktit që Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural tashmë e sa vite ofron programe të mbështetjes financiare prej miliona euro në mbështetje të fermerëve, një mekanizëm i mirëfilltë monitorues lë shumë për të dëshiruar. Mungesa e koordinimit ndërmjet palëve të përfshira si dhe mungesa e digjitalizimit, lënë mjaft hapësirë për keqpërdorim të fondeve publike. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë ka qenë, dhe duhet të jetë një nga prioritetet e secilës qeveri, mirëpo, synimi i tyre për rritjen e produktivitetit, zvogëlimin e importit të produkteve bujqësore, rritjen e numrit të të punësuarve, themelimin e një tregu të qëndrueshëm bujqësor, konsiderohet se nuk u realizuan në masë të kënaqshme. Mjaft e vështirë është të përcaktohet shkalla e keqpërdorimeve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në politikat mbështetëse, pasi që edhe vetë institucionet përkatëse shpeshherë nuk posedojnë të dhënat relevante në kohë.

“GRANTET I U JEPEN NJERËZVE TË FUQISHËM DHE NË VEND SE ATO T’I JEPEN ATYRE QË KANË NEVOJË DHE QË MBAJNË BAGËTITË E TYRE NË STALLA DHE KUSHTE MJERUESE, MINISTRIA IU JEP GRANTE ATYRE QË KANË PARA DHE JANË MILIONERË! [25]”

Kritikat e ashpëra për keqpërdorim të fondeve mbështetëse datojnë qysh në vitin 2015. Sipas Sindikatës të Bujqëve në Kosovë, përfitues të granteve dhe subvencioneve janë persona të cilët as që mirren me bujqësi [26]. Fitimi i traktorëve nëpërmjet granteve, sipërfaqe ari dhe prodhimtari bujqësor të subvencionuara e të pambjellura, vetëm sa kanë dëmtuar fermerët e zellshëm, rrjedhimisht, tregun bujqësor. Nëse miliona euro subvencione do të konvertoheshin në produkte bujqësore, tregu do të lulëzonte nga të korrurat, të mirat bujqësore: Në prani të konkurrencës, me çmime dukshëm më të përballueshme. Keqpërdorime si dhe keqmenaxhim i procesit të ndarjes së fondeve mbështetëse janë evidentuar gjithashtu nga njohës të sektorit të bujqësisë, ani pse këto aktakuza ishin hedhur poshtë nga ministri i bujqësisë duke shtuar se grantet po ndahen në mënyrë transparente [27], nëpërmjet një platforme e cila jo gjithnjë rezulton të jetë e funksionale.

Për faktin se ka pasur menaxhim jo të mirë të subvencioneve është bërë e ditur edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Në raportin e auditimit të performancës me titull: “Procesi i Menaxhimit të Granteve dhe Subvencioneve në Sektorin e Bujqësisë”, qëllimi i të cilit është të promovojë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme nga menaxherët e çdo organizate të audituar [28], në pajtim me Zyrën e Kryeministrit, ka ardhur në përfundim se: “... mënyra aktuale e menaxhimit të programeve për bujqësi nuk siguron arritjen e rezultateve të synuara për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Ndër tjera, procesi në tërësi u shqua për menaxhim jo të mirë të paradhënies për investimet në infrastrukturën rurale, raste të mosplotësimit të kriterëve nga përfituesit siç janë të përcaktuara me udhëzim administrativ, mangësi në procesin e dhënies së programeve, kontrolleve dhe monitorimit dhe mangësi në hartimin e strategjive dhe programeve afatgjate [29]. Për më tepër, ZKA-ja ka bërë të ditur që:

[25] Militantët, përfitues të granteve dhe subvencioneve në bujqësi, Bota Sot, e qasshme në:

<https://www.botasot.info/ekonomi-lajme/567896/militantet-perfitues-te-granteve-dhe-subvencioneve-ne-bujqesi/>

[26] Ibid;

[27] Ibid;

[28] Raporti i Auditimit të Performancës Procesi i Menaxhimit të Granteve dhe Subvencioneve në Sektorin e

Bujqësisë, Zyra Kombëtare e Auditimit, e qasshme në: [http://www.zka-rks.org/wp-](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf)

[content/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf)

[29] Ibid;

“MINISTRIA ENDE NUK KA RREGULLORE APO PLANE QË PËRCAKTOJNË QARTË ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE NË ASPEKTIN KOHOR DHE PROCEDURAL. APROVIMI I PROGRAMEVE SHPESHHERË VONOHET DUKE SHKAKTUAR VONESA NË SHPALLJEN E TYRE DHE DUKE NDIKUAR NË TËRË PROCESIN DERI TEK EKZEKUTIMI PAGESAVE”. [30]

Të ngarkuar me veprat penale “mashtim me subvencione”, “falsifikim të dokumenteve”, “mbushje e aplikacioneve”, “ndërrim të kulturave bujqësore”, “marrje e ryshfetit” dhe “mashtim në detyrë”, të akuzuarit e gjetën vetën në paraburgim. Prokuroria pretendon se me këto veprime, të akuzuarit në bashkëkryerje i kanë shkaktuar dëm Buxhetit të Republikës së Kosovës në vlerën minimale prej 400,000.00 euro [31]. Nëse mbrenda një kohe të caktuar të po njëjtit vit dhe po të njëjtës thirrje për subvencione, është dëmtuar buxhet i Republikës së Kosovës nga një numër i vogël i personave, atëherë dëmi i vërtetë me mbi 20 thirrje të hapura ndër vite mbetet të hamendësohet.

MILIONA EURO INVESTIME TË PEZULLUARA, MILIONA EURO PRODUKTE BUJQËSORE TË IMPORTUARA. NË NJËRËN ANË FERMA INNOVATIVE TË BOSHATISURA, NË ANËN TJETËR STALLA TË IMPROVIZUARA!

Lufta kundër korrupsionit në sektorin e bujqësisë është një sfidë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe mjedisit rural. Përpjekjet e vazhdueshme të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare e kanë renditur shtetin e Kosovës në vendin e 84 [32] nga gjithsejtë 180 shtete, duke shënuar progres në krahasim me vitin paraprak për rritje të transparencës. Megjithatë, përderisa e tërë vëmendja është përqendruar tek rritja e transparencës dhe llogaridhënies, politikat e sektorit më me potencial vazhdojnë të mbesin të njëjta. Mungesa e të dhënave, publikimi i raporteve me vonesë, kostot e larta të produkteve, keqmenaxhimi i procesit të shpërndarjes së granteve dhe subvencioneve, mungesa e fuqisë punëtore, mungesa e sigurimit bujqësor, mungesa e këshilldhënies, shtyrja e afateve kohore, rritja e importit, privatizimi i tokave bujqësore, infrastruktura e dobët si dhe mungesa e digjitalizimit të procesit të shpërndarjes të fondeve mbështetëse, lënë hapësirë të mjaftueshme për keqpërdorim të parasë publike edhe në ditët e sotme.

[30]Raporti i Auditimit të Performancës Prosesi i Menaxhimit të Granteve dhe Subvencioneve në sektorin e Bujqësisë, Zyra Kombëtare e Auditimit, e qasshme në: http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf

[31]CORRUPTION PERCEPTIONS INDEX, Transparency International, e qasshme në: <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/ksv>

[32]CORRUPTION PERCEPTIONS INDEX, Transparency International, e qasshme në: <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/ksv>

Bujqësia në Kosovë pothuajse njësoj ndër vite, përballet me probleme të thella strukturore, pasojë e të kaluarës dhe e karakteristikave të familjeve kosovare, duke filluar që nga identifikimi i parcelave të tyre. Mungesa e sistemeve inovative të sistemeve të ujitjes, mungesa e sistemeve të mbrojtjes kundër breshërit, mosaplikimit të automatizimit – pajisjeve moderne bujqësore dhe së fundmi, mungesa e fuqisë punëtore, nuk po shfaqin rezultat përkundër faktit që, buxheti i ndarë për subvencione dhe grante nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është vazhdimisht në rritje. Tani për tani, më e rëndësishme do të ishte të bëhej një analizë e kapaciteteve të kulturave bujqësore si dhe të bëhet një vlerësim i efikasitetit të granteve dhe subvencioneve në bujqësi.

Asnjëherë deri më tash, praktikisht nuk është saktësuar zyrtarisht sa janë sipërfaqe të tokës me bukë në Kosovë, as mbjelljet me kultura vjeshtore, ose sa me ato pranverore. Nuk dihen saktësisht as rendimentet mesatare në nivel të vendit, sasi të e korrurra nga një fermer, i cili i shpallë dhe i publikon rendimentet nga të lashtat e tij [33], apo sa fermerë vërtetë ushtrojnë këtë veprimtari. Në anën tjetër, kulturat bujqësore, aq sa janë, nuk po subvenciohen në përputhje me sezonën e tyre përkatëse. Shtuar këtë fakt, këtë pasiguri po e forcojnë edhe luhajtjet e shpeshta si pasojë e kërkesave të larmishme të tregut. Qëllimi i granteve dhe subvencioneve është të përkrah prodhuesit nga paqëndrueshmëria e tregut, rritjes së inflacionit nga faktorët e jashtëm dhe të forcoj segmentin bujqësor të ekonomisë kombëtare dhe jo të pasuroj individë përderisa çmimet në treg janë të papërbalueshme .

A PO I PASQYROJNË ÇMIMET VËRTET KOSTOT E PRODHIMIT? SA JANË DUKE NDIKUAR VËRTETË SUBVENCIONET DHE GRANTET NË RITJEN E PRODUKTIVITETIT NË VEND?

Si përfundim, është evidente që bujqësia në Kosovë përkundër parakushteve të favorshme për të qenë një vend i vyer bujqësor, vazhdon të përballet me sfida të mëdha të cilat e pengojnë zhvillimin e tij si një sektor me vlerë të shtuar për shkak të politikave të gabuara dhe mungesës së vizionit për të promovuar zbatimin e strategjive efektive në shumë nënsektorë të saj. Kjo ka rezultuar në çmime të larta të produkteve bujqësore në vend, edhe më të larta se të produkteve që importohen nga jashtë vendit siç është rasti me produktet e qumështit. Për të ruajtur një sektor bujqësor dhe për të shtuar vlerë, të qëndrueshëm dhe konkurrues në treg është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të përmirësuar politikat dhe strategjitë bujqësore.

[33] Bujqësia në Kosovë, sektori i nënçmuar i vendit, Buletiniekonomik, e qasshme në: <https://buletiniekonomik.com/2023/09/bujqesia-ne-kosove-sektori-i-nencmuar-i-vendit/>

REKOMANDIME

1 Të ulen kriteret për aplikim për subvencione dhe grante me qëllim të gjithëpërfshirjes, ku të gjithë bujqit dhe fermerët mund të jenë fitues. Zhvillimi i programeve që kanë një gamë të gjerë të mbështetjes, përzgjedhja e kujdesshme e masave mbështetëse dhe zbatimi i procedurave adekuate gjatë zbatimit të tyre e pasurojnë tregun vendor dhe kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor. Kjo ndihmon në përmirësimin e jashtëzakonshëm të aftësisë së komunitetit bujqësor për të përfituar nga burimet dhe për të krijuar një ekonomi vendase të qëndrueshme.


2 Të përcaktohen afate kohore për përgatitjen dhe ekzekutimin e programeve për grante dhe subvencione, me qëllim të të miratimit të programeve në kohën optimale të të mbjellurave sezonale. Procesi i skemave mbështetëse të granteve përcillet me vonesa që nga aprovimi i tij, hapja e thirrje, deri tek nënshkrimi i kontratës. Sipas akteve nënligjore kjo kohëzgjatje mund të zgjasë deri në 3 muaj, ndërkaq në realitet, procesi përcillet me vonesa edhe më të gjata. Andaj, është më se e domosdoshme të caktohen afatet kohore për hapjen e thirrjeve për procesin e aplikimit për grante dhe subvencione në perioda saktësisht të njëjta për çdo vit. Marrë parasysh që bujqësia është prodhimtari sezonale, kjo do ta ndihmonte aplikimin e bujqve për mbështetje për të mbjella në përputhje me planifikimet e gjendjes në terren.

3 Të kryhen kontrolla të rregullta dhe të hulumtohet tregu pas implementimit të skemës së granteve dhe subvencioneve për vitin përkatës. Kontrollat duhen kryer nga personat autorizues, inspektorë, njohës të sektorit të bujqësisë, si dhe të angazhohen palë të jashtme kontraktuese me qëllim të mbarëvajtjes të procesit. Aktualisht mungojnë të dhënat për rezultatet e synuara dhe nuk ka shënime që pasqyrojnë impaktin e skemave mbështetëse në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Angazhimi i palëve të tjera, përfshirë shoqërinë civile do të siguronte monitorim më rigoroz të matjes së impaktit të fondeve mbështetëse.

4 Të kryhen studime dhe analiza rreth mundësive të përshtatshmërisë për kultivimin e kulturave bujqësore. Kulturat e mbështetura jo gjithmonë kanë qenë të përshtatshme për kultivim në territorin e Kosovës. Kjo mund të orientojë sektorin e bujqësisë drejt kulturave që nuk janë profitabile për tregun tonë apo që nuk i përmbushin kërkesat e tregut. Duhet të kryhen studime të fiziibilitetit nga ekspertët bujqësor, rezultatet e të cilave duhet shpalosur me hartuesit e programeve.

5 MBPZHR-ja duhet të sigurohet që gjatë gjithë procesit, shuma e miratuar të shpenzohet brenda kufijëve buxhetor të ndarë për atë vit në përputhje me Programin e Zhvillimit Rural. Për shkak të vonesave në aprovim të programeve dhe hapje të thirrjeve, shpeshherë pagesat po barten për vitin e ardhshëm. Fakti që shuma e ndarë dhe ajo e implementuar e granteve dhe subvencioneve asnjëherë nuk përkojnë me njëra tjetrën, vështirëson planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Institucionet kompetente duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë, në rast të dështimit të zbatimit të projektit pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin në fjalë.

6 Të përditësohet si dhe të publikohet lista e zezë e cila përmban emrat e bujqve që kanë qenë të përfshirë në raste të njohura për korrupsion, keqpërdorim të mjeteve. Kjo listë do të përdoret për të caktuar sanksione që do të ndalojnë aplikimin e tyre për subvencione dhe grante për një periudhë prej tre vitesh ose më shumë. Kjo masë ka për qëllim të promovojë sjelljen dhe aktivitetet ligjore në sektorin bujqësor dhe të ndikojë në përmbushjen e rregullave dhe rregulloreve të ndërlydhura.



7 Ministria, në bashkëpunim me agjencitë përkatëse, duhet të sigurojë të dhëna për të hartuar programet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut. Në sektorin bujqësor, ka një mungesë të të dhënave të sakta lidhur me bujqësinë në Kosovë. Është e rëndësishme të disponohen informacione precise në lidhje me numrin e bizneseve bujqësore aktive, demografikën e popullatës që jeton në zonat rurale, dhe potencialin e tyre për punësim në bujqësi. Gjithashtu, është e rëndësishme të kemi njohuri të sakta për numrin e familjeve që janë të varura nga të ardhurat e tyre nga bujqësia dhe sa prej tyre e kryejnë atë si veprimtari shtesë.

8 Të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe Drejtorive për Zhvillim Rural në nivel lokal. Disa individë ishin përfitues të dyfishtë ndërkaq disa të tjerë janë ankuar që në mënyrë të padrejtë nuk ishin subvencionuar. Ministria duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me komunat për të koordinuar aktivitetet e ngjashme lidhur me përzgjedhjen e përfituesve në mënyrë që të siguroj që të mos ketë përfitues për masën e njëjtë nga të dy nivelet mbrenda të njëjtit vit. Gjithashtu, AZHB-ja duhet të vendosë komunikim të rregullt me palët e treta, qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve sidomos gjatë kohës së thirrjeve publike.

9 Gjatë procesit të dhënies së granteve të mëdha, siç janë mjetet bujqësore, është e rëndësishme të implementohet një sistem rotativ ndërmjet përfituesve dhe bujqve, në mënyrë që të sigurohet një përdorim efikas dhe i qëndrueshëm i këtyre burimeve. Ky sistem lejon që bujqit të shfrytëzojnë mjetet për një periudhë të caktuar dhe pasi ata nuk i përdorin ato për arsye të ndryshme, t'i transferojnë tek bujqit tjerë. Kjo ndihmon në maksimizimin e përdorimit të këtyre mjetëve, përmirësimin e produktivitetit bujqësor, dhe përkrahjen e komunitetit bujqësor në përdorimin e burimeve të përbashkëta, duke shmangur që ato të mbeten pasive dhe të mos shfrytëzohen për përdorim.

10 Për të përmirësuar mënyrën e aplikimit dhe procesin e vlerësimit të aplikacioneve për grante dhe subvencione, si dhe për të garantuar një nivel më të lartë të transparencës në tërë procesin, është shumë e rëndësishme që të digjitalizohet sistemi i aplikimit. Kjo do të rezultojë në zvogëlimin e kohës së aplikimit, pritjeve të tepruara të qytetarëve nëpër institucione dhe reduktimin e mundësive për gabime të mundshme në procesin e aplikimit dhe vlerësimit. Digjitalizimi i paraprën monitorimit duke ulur mundësinë për keqpërdorime, duke e bërë të vështirë manipulimin e procesit në mënyrë të parregullt.

11 Të vendosen mekanizma rregullues me qëllim të mbrojtjes së cmimit në treg. Subvencionimi i produkteve sipas çmimit është një mjet i rëndësishëm për të siguruar qasje të barabartë të çdo qytetari në mallra dhe shërbime të rëndësishme. Ky veprim jo vetëm që ndihmon në luftën kundër varfërisë dhe paaftësisë ekonomike, por gjithashtu inkurajon prodhimin vendas dhe përmirëson stabilitetin e tregut. Nëpërmjet subvencioneve të çmimeve, shteti mund të ndikojë në aftësinë e qytetarëve për të patur akses në produkte të nevojshme dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo është një strategji e rëndësishme për të mbështetur mirëqenien e përgjithshme dhe për të ndihmuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.



Projekt i mbështetur nga:

Projekt i zbatuar nga:

